



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 152 Datë 12.11.2012

PËR

**RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TE
ENERGJISE ELEKTRIKE MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 68, DATË 23.06.2008**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma ç, paragrafi “ii”, 9 dhe 54 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Në Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, të shtohet pika 2 me përmbajtjen si vijon: *“Cdo pjesëtar i tregut, që ka përgjegjësi për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, kur argumenton që rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike e konsumatorëve fundorë, mund të bëjë kërkesë në ERE, që Bordi i Komisionerëve të alokojë me të drejta të siguruara kapacitetet e lira të muajit pasardhës, pa çënuar të drejtat e rezervuara në ankandet vjetore. Bordi i Komisionerëve do vendosë rast pas rasti, për periudha jo më të gjata se një muaj, mbi bazë të argumentave të paraqitura në kërkesë.*
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a, CEZ Shpërndarje sh.a dhe shoqatën AEES, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI